

Programi nuklear i Koresë së Veriut dhe Iranit- qasje krahasuese

*Mentor LECAJ**

Abstrakti

Ky punim synon që me krahasimin e këtyre dy rasteve, të krijojë një pasqyrë të qartë të problematikës, të cilat paraqesin këto shtete për sigurinë rajonale dhe globale, si dhe zgjidhjen e tyre me mjete dhe instrumente adekuate. Me krahasimin e efektit juridik, politik dhe diplomatik të këtyre programeve nukleare, të cilat ndikojnë në hartimin e strategjive të shteteve më të fuqishme në botë, synohet të nxirren në pah dallimet ndërmjet tyre.

Metodologjia që do të perdoret në këtë punim do të jetë analizë e literaturës ekzistuese, akteve juridike ndërkombëtare si dhe deklaratave të përfaqësuesve të aktorëve të kyçur në zgjidhjen e krizës, të cilat janë pjesë e problemit.

Gjetjet e këtij punimi kanë të bëjnë me atë se: pos që ekzistojnë elemente të përbashkëta ndërmjet këtyre rasteve, ekzistojnë dallime të rëndësishme ndërmjet tyre. Mjetet dhe instrumentet e njëjta diplomatike në zgjidhjen e këtyre krizave nuk kanë efekte të njëjta. Kjo e bën që secili rast të jetë i veçantë dhe i pakrahasueshëm në zgjidhjen e krizës.

Duke patur parasysh lieteraturën ekzistuese mbi këtë materie, ky punim do të plotësojë zbrazëtirat shkencore sa i përket gjetjes së dallimeve të këtyre rasteve, si dhe aplikimit të mjeteve të mundëshme në zgjidhjen e krizave bërthamore në të ardhmen.

Fjalë kyç: *Kore e Veriut, Iran, program nuklear, komuniteti ndërkombëtar*

*Mentor Lecaj, born on 02/04/1978, lives in Pristina, Kosovo, PhD student in the field of International Law, working as a lecture at AAB College, Pristina, Kosovo, e-mail:mentor.lecaj@aab-edu.net.

Hyrje

Duhet patur parasysh se në rastin e programit nuklear të Koresë së Veriut, mund të themi lirshëm, se në aspektin shkencor, i tërë regjimi ndërkombëtar i mospërhapjes bërthamore ka dështuar. Sa i përket programit nuklear të Republikës Islamike, në momentin e shkrimit të këtij artikulli është i stopuar procesi i pasurimit të uraniumit deri në nivelin 5%, si rezultat i arritjes së marrëveshjes gjithpërfshirëse ndërmjet P5+1(SHBA-së, Federatës Ruse, Kinës, Britanisë së Madhe, Francës dhe Gjermanisë në njërën anë dhe Republikës Islamike në anën tjetër). Të dyja këto raste kanë rëndësi juridiko-ndërkombëtare, pasi janë aplikuar një mori e instrumentave juridike (sanksione), disa kanë patur sukses në periudha kohore të caktuara, e më vonë kanë dështuar. Disa kanë patur efekt në përdorimin e tyre në një shtet, ndërsa në tjetrin nuk kanë patur efektin e njëjtë. Nga aspekti politik dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare, të dyja këto raste paraqesin sfida gjatë hartimit të strategjive politike të fuqive të mëdha, në realizimin dhe mbrojtjen e ineteresave vitale të tyre. Sa i përket fushës së sigurisë, po ashtu këto shtete ndikojnë në mënyrë parësore në hartimin e politikave të sigurisë, të shteteve fqinje.

Ngjashmëritë dhe dallimet

Kriza bërthamore është një konfrontim serioz midis mbrojtësve të normave ndërkombëtare, të cilat ofrojnë shansin më të mirë për paqen dhe stabilitetin e një shteti mashtrues që duket se synojnë të zotërojnë armët e shkatërrimit në masë, të cilat japin atë mundësi për të kërcënuar stabilitetin, për të mbrojtur

interesat e ngushta të regjimit.¹ Sigurisht që krahasimi i krizës bërthamore të Iranit me krizën bërthamore të Koresë së Veriut, duhet të fillojë nga analizimi dhe krahasimi i regjimeve politike në këto dy vende. Optimistët në këndvështrimin e tyre ndaj Iranit kanë parasysh civilizimin e Iranit, pushtetin e fuqishëm tregtar, rritje në pasurinë e naftës, me një gjeneratë të re, një vend më pluralist se çdo vend tjetër në Lindjen e Mesme. ² Që nga ndarja e Gadishullit Korean, si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, Koreja e Veriut ka qenë e udhëhequr nga vetëm 3 njerëz: Kim Il-sung dhe djali i tij, Kim Jong-il, dhe në fund Kim Jong -un. ³ Koreja e Veriut mbetet vendi i vetëm i vetizoluar nga shumë vende të botës dhe se qeveria është një nga më të errëtat në tokë.⁴ Të dyja regjimet janë formuar dhe udhëhequr nga demagogë karizmatikë, me nivele të larta të veprimeve retorike ndaj luftës së shtresave të pasura dhe të korrupuara shoqërore. Por dallimi qëndron tek motivet fetare dhe justifikimet e Khomeinit, (liderit shpirtëror dhe revolucionit islamik, 1979), të cilat nuk mund të gjenden në Korenë e Veriut. Khomeini ka nxitur revolucionin e tij kundër keqmenaxhimit, keqpërdorimeve materiale dhe laicizmit të një lideri të brendshëm, ndërsa Kim Il Sung, mori iniciativën së bashku me nacionalistët e tjerë, për ta çliruar vendin e tij nga kolonialistët e huaj. Khomeini ishte një dijetar fetar me ide të formuara mirë mbi qeverisjen, ndërsa Kim Il Sung ishte një

¹ Gilbert, Rozman, *Strategic Thinking about the Korean Nuclear Crisis: Four Parties Caught between*

North Korea and the United States, Palgrave, Macmillian, 2007, fq. 27.

² Patrick M. Cronin, *Double Trouble, Iran and North Korea as Challenges to International Security*, Praeger Security International, Westport, Connecticut London, 2008, fq. 11.

³ John, Ishiyama, "Assessing the leadership transition in North Korea: Using network analysis of field inspections", 1997-2012, Department of Political Science, University of North Texas, 1155 Union Circle # 305340, Wooten Hall, Room No. 166, Denton, TX 76203-5340, United States, 2014, pg.1.

⁴ Patrick M. Cronin, *Double Trouble, Iran and North Korea as Challenges to International Security*, Praeger Security International, Westport, Connecticut London, 2008, fq.79.

luftëtar i paarsimuar gueril, që ishte i nevojshëm vetëm për të menduar për qeverisjen pas disfatës së Japonisë. Kim Il Sung ka krijuar një sistem ideologjik në bazë të ndjesisë anti-imperialiste, ka inkorporuar ekonomi socialiste, por kjo në fund të fundit nuk është ideologji që ka të mirën e një feje të madhe botërore për të justifikuar rolin e tij, apo për të bërë premtime për shpërblimet në jetën tjetër. Ai ka investuar më shumë në përpjekjet për të promovuar indoktrinimin ideologjik dhe shtypur disidentët për të siguruar sundimin e tij. Këto dallime kanë prodhuar dy sisteme politike me fundacione të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të shtetit.⁵ Koreja e Veriut dhe Irani janë në thelb shtete të ndryshme. Edhe pse të dyja këto vende ndjekin disa politika të rëndësishme të huaja me interes për Shtetet e Bashkuara, prapë se prapë ato ekzistojnë në rajone të ndryshme me divergjenca të ndryshme kulturore, nevoja të sigurisë, ekonomi jashtëzakonisht të ndryshme, ideologji dhe koncepte shumë të ndryshme fetare dhe politike. ⁶ Mirëpo, sa i përket programeve bërthamore të këtyre dy vendeve, kryeministri izraelit Netanjahu, në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ka deklaruar se Irani nuk duhet të lejohet që të përsëritë dredhitë e Koresë së Veriut për të poseduar armë bërthamore!⁷ Duke u bazuar në deklaratat e Sekretarit të shtetit John Kerry, pas presionit nga autoritetet izraelite, se çështja e Iranit po shkon të njëjtës rrugë si Koreja e Veriut, Kerry kishte refuzuar të bënte krahasime midis marrëveshjes bërthamore me Iranin dhe marrëveshjes së

⁵ McEachern, *North Korea and Iran, Drawing Comparative Lessons*, US.-Korea Institute at SAIS, 2011, fq. 12.

⁶ Ibid, fq. 20.

⁷ Tovah, Lazaroff, "Netanyahu to compare Iran with North Korea in UN speech", The Jerusalem Post, 24.09.2013, <http://www.jpost.com/Diplomacy-and-Politics/Netanyahu-to-compare-Iran-with-North-Korea-in-speech-to-UN-326918>, 26.02. 2014.

negociuar në të kaluarën me Korenë e Veriut⁸. Gjatë një interviste në CNN, më 25 Nëntor 2013, Kerry u pyet në këtë formë: "Shumë njerëz thonë se Irani do të jetë i njëjtë si Koreja e Veriut, një vend që përkohësisht pajtohet për të *ndaluar* ambicjet e saj bërthamore në mënyrë që të hiqen sanksionet dhe pastaj fshehurazi shkon përpara dhe vazhdon me programin e saj bërthamor. Pse mendoni se rasti i programit nuklear të Iranit nuk është i ngjashëm me rastin e programit nuklear të Koresë së Veriut? Sekretari i SHBA-ve -Kerry, përgjigjet në atë mënyrë duke krahasuar detajet e të dy rasteve, ku:

E para, Irani është "anëtar i NPT-së".

E dyta, Iranianët "janë përfshirë në negociata".

E treta, Iranianët "janë angazhuar që të kenë inspektime të përditëshme të objekteve të caktuara dhe për të kufizuar aktivitetet e tyre me këto inspektime".

E katërta- Iranianët "kanë deklaruar publikisht se ata nuk do të ndërtojnë armë bërthamore". Në kontrast me Iranin, shtoi ai se, "Koreja e Veriut tashmë ka dhe ka testuar armët bërthamore dhe nuk ka deklaruar asnjë politikë të denuklearizimit. Pra, ka shumë gjëra të ndryshme dhe se ne duhet të mundohemi që të gjejmë mundësinë e një zgjidhjeje diplomatike me Iranin".⁹ Por kritikët e deklaratës së Kerrit, përmendin fakte të tjera, duke shtuar se administrata e Klintonit kishte negociuar me Korenë e Veriut dhe kishte nënshkruar Kornizën në Gjenevë, pothuajse dy dekada më parë. Koreja e Veriut ishte gjithashtu "një anëtar i NP-së", ajo e kishte kërcënuar në vitin 1993 të tërhiqej nga traktati. Koreja e Veriut gjithashtu kishte "negociata" (Korniza e Pajtitimit

⁸ Marrëveshja Kornizë e nënshkruar në vitin 1994 mes Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut,

⁹ Patrick, Goodenough, "Kerry Misleads in Saying There's No Comparison Between Iran and N. Korea Nuke Deals", CNN, news, November 25, 2013, <http://cnsnews.com/news/article/patrick-goodenough/kerry-misleads-saying-theres-no-comparison-between-iran-and-n-korea>.

u nënshkrua pas katër muaj bisedimesh dypalëshe mes Washingtonit dhe SHBA-së dhe Phenianit)¹⁰. Koreja e Veriut gjithashtu kishte deklaruar publikisht se ata nuk do të ndërtojnë armë bërthamore" (Deklarata e përbashkët Jug - Veri për denuklarizimin e Gadishullit Korean" të nënshkruar në vitin 1991). Pheniani deklaroi se nuk do të provojë të prodhojë, të marrë, të posedojë, të vendosë, ose të përdorë armë bërthamore. Vetëm një nga këto katër arsytet e cituara nga Kerry ishte ndoshta e saktë. Ndryshe nga marrëveshja me Iranin, në deklaratën e pajtimit nuk përcaktohen "inspektimet e përditshme" të objekteve bërthamore të Koresë së Veriut, por ajo kishte lejuar Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për të "monitoruar" objektet bërthamore të caktuara, dhe për të kryer "ad hoc inspektime rutinore të objekteve",¹¹

Përpjekjet për t'i kuptuar se çfarë aftësi ushtarake kanë të dy vendet, Irani dhe Koreja e Veriut, është e sigurtë se të dyja kanë aftësi për të ndikuar në hartimin e politikave të mbrojtjes së SHBA-ve dhe fqinjëve të tyre. SHBA-të kanë vendosur të zgjerojnë mbrojtjen e saj raketore në Alaska për të kundërshtuar një sulm të mundshëm nga Koreja e Veriut me raketa balistike. Po ashtu kërcënimi nga Irani në mënyrë të ngjashme ka nxitur planifikimin amerikan të mbrojtjes nga raketat, shitjet e armëve dhe vendimet e tjera politike. Irani dhe Koreja e Veriut ndajnë gjithashtu disa karakteristika të rëndësishme, të dyja qeverisen nga regjime autoritare, të dyja vendet kanë lëshuar kërcënime shqetësuese për fqinjët, që janë aleatë të SHBA-ve dhe të dyja kanë mbetur të papajtueshme, pavarësisht dënimit të ashpër ndërkombëtar dhe sanksioneve të rrepta. Megjithatë, nga

¹⁰ Agreed Framework between The United States of America and The Democratic People's Republic Of Korea, Geneva, October 21, 1994.

¹¹ Patrick, Goodenough, "Kerry Misleads in Saying There's No Comparison Between Iran and N. Korea Nuke Deals", 25.11. 2013., <http://cnsnews.com/news/article/patrick-goodenough/kerry-misleads-saying-theres-no-comparison-between-iran-and-n-korea#sthash.YInGfm7I.dpuf>, 11.03. 2014.

pikëpamja e aftësive, vendet nuk duhet teknikisht të grupohen në të njëjtën kategori për një arsye shumë të qartë, sepse, Koreja e Veriut ka arsenal bërthamor, ndërsa Irani nuk posedon. Mirëpo ngjashmëri kanë të dyja. Edhe pse Irani nuk ka arsenal bërthamor, ai mund të godasë ushtarakisht në shenjë hakmarrjeje objektivat izraelite dhe amerikane. Ballafaqimi mund të eskalojë në një luftë destabilizuese rajonale në Lindjen e Mesme, e cila është e paqëndrueshme dhe e gjithë kjo nuk garanton se Irani nuk do të mund të rindërtojë objektet e saja bërthamore disa vjet më vonë. Më e keqja është se veprimi i parakohshëm ushtarak do të ngjallë zemërim dhe pasiguri në Iran, që ndoshta do ta detyrojë qeverinë e saj të nisë një shkallë të plotë në programin e armëve bërthamore, i cili vendim akoma nuk është bërë. Arsyeja për optimizëm, ndryshe nga "mbretëria e vetmuar" e Koresë së Veriut, është se Irani është i integruar në ekonominë globale dhe i varur nga tregtia ndërkombëtare. Pra, sanksionet ekonomike duhet të japin shumë më tepër efekt me Iranin se sa me Korenë e Veriut. Me Iranin, negociatat e vazhdueshme mund të ofrojnë mundësi për të ndaluar një program bërthamor ende të sapolindur.¹²

Një pjesë e madhe në përparimin aktual diplomatik është pjesërisht zgjedhja e presidentit iranian Hassan Rouhani. Shumë shpejt pas inaugurimit të tij, SHBA -të dhe Irani kanë angazhuar drejtpërdrejt takime në nivelet më të larta që nga viti 1979. Edhe pse udhëheqësi suprem i Iranit Ajatollah Ali Khomeini mbetet akoma pushteti i fundit vendimmarrës në Teheran, ai u është përgjigjur pozitivisht Rouhanit dhe Ministrit të Jashtëm Javad Zarif për t'ua mundësuar kohën dhe hapësirën e nevojshme deri

¹² Usha, Sahay, "A Tale of Two Outliers: Comparing Options on Iran and North Korea", Lobelog Foreign Policy, 22.02.2013, <http://www.lobelog.com/a-tale-of-two-outliers-comparing-options-on-iran-and-north-korea>.

te një marrëveshje.¹³ Dallim nga Koreja e Veriut është se asnjë nivel i tillë i përgjegjësisë, nuk është bartur tek autoritetet e tjera koreane, ku familja Kim sundon me dorë të hekurt që prej viteve të 50-ta të shekullit të kaluar. Bisedimet midis palëve të interesuara dhe Koresë së Veriut filluan pasi Koreja e Veriut ishte avancuar shumë afër armatimit bërthamor. Kur marrëveshja e vitit 1994 ishte nënshkruar, Koreja e Veriut tashmë kishte një reaktor me ujë të rëndë funksional, kishte prodhim të mjaftueshëm për të përfunduar një armë bërthamore. Një pjesë e madhe e marrëveshjes së përkohshme me Iranin është ngrirja e progresit në uzinën e ujit të rëndë në Irak, e cila gjithashtu do të jetë në gjendje për të prodhuar plutonium. Koreja e Veriut ishte e vendosur për të ndërtuar një bombë, ndërsa udhëheqësit e Iranit kanë ende kohë për të marrë një vendim lidhur me armët bërthamore.¹⁴

Sipas zyrtarëve të OKB-së dhe të SHBA-ve, Koreja e Veriut ka aftësi për të prodhuar dhjetëra bomba bërthamore, ndërsa Irani nga ana tjetër ka zhvilluar vetëm teknologji për pasurimin e uraniumit. Irani ka gjithashtu një marrëveshje, e cila është në fuqi

¹³ Më 14 Korrik, 2015, P5+1 (Kina, Franca, Germania, Rusia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara), dhe Unioni Evropian (EU), dhe Iranian kanë arritur marrëveshjen, e quajtur Plani i Përbashkët Gjithpërfshires i Veprimit (Joint Comprehensive Plan of Action –JCPOA) që të sigurojë se programi nuklear i Iranit, do të jetë për qëllime paqësore. Më 18 Tetor, 2015 u shënuua dita e miratimit të JCPOA, datë kjo, në të cilën JCPOA ka hyrë në fuqi dhe pjesëmarrësit filluan të marrin hapat e nevojshme për ta implementuar atë. Më 16 Janar 2016, shënohet dita e implementimit të JCPOA. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA) ka verifikuar se Irani ka implementuar masat kyçe nukleare, të cilat janë shënuar në JCPOA, dhe Sekretari i shtetit ka konfirmuar verifikimin e IAEA-së. Si rezultat i kësaj, Irani pasi plotësoi detyrimet e tij nukleare, SHBA-të dhe EU kanë hequr një mori të sanksioneve që lidhen me programin nuklear siç përcaktohet në JCPOA., për më tepër vizito, *US. Department of State*, <http://www.state.gov/e/eb/tfs/spi/iran/jcpmiratimitoa/>.

¹⁴Brown, Hayes, “5 Reasons Why The Iran Deal Isn’t North Korea Redux”, Think Progress, 25.11.2013, <http://thinkprogress.org/security/2013/11/25/2989171/iran-deal-north-korea-redux/#, 22.02. 2014>.

me IAEA, që i lejon zyrtarët për të vizituar reaktorët bërthamorë - karburantin iranian. Pheniani, në anën tjetër ka dëbuar inspektorët e IAEA- nga kompleksi Yongbyon në vitin 2002. Në këtë moment, Koreja e Veriut është shumë më e paparashikueshme dhe një entitet më me rrezik se sa Irani.¹⁵ Ndryshe nga Irani, ku feja ka vlera më tepër se shteti, Koreja e Veriut kujdeset shumë më shumë për mbijetesën e vet, e cila mund të jetë edhe fakt për të përdorur bombën e saj.¹⁶

BE-ja dhe SHBA-të janë kryesisht më të shqetësuara me evoluimin e situatës në Iran, se sa në Korenë e Veriut. Një Iran bërthamor konsiderohet potencialisht i rrezikshëm jo vetëm për shkak se Evropa shtrihet nga aspekti gjeografik brenda rrezes së raketave të Iranit, por edhe rajoni, ku shtrihet Irani është i minuar me tensione dhe konfrontime të paqëndrueshme. Në veçanti Izraeli është i vendosur për të parandaluar Teheranin nga përvetësimi i bombës. Një Iran bërthamor mund të çojë në një garë të re të armëve në Lindjen e Mesme dhe të destabilizojë më tej rajonin, i cili gjendet afër Evropës. Fuqia diplomatike e Evropës do të testohet varësisht nga ajo se sa Irani gjendet afër finalizimit të programit të tij bërthamor. Ndarjet në mes të vendeve të BE -së ka të ngjarë të rriten në lidhje me atë se çfarë duhet bërë më tutje, por edhe me aleatin kryesor të Evropës, SHBA-të. Për Bashkimin Evropian, Koreja e Veriut ka tërhequr shumë vëmendje në aspektin e mospërhapjes gjatë dekadës së fundit, por gadishulli korean gjeografikisht gjendet larg dhe në

¹⁵Ahmad, Shahab, "North Korea News; Who is more dangerous, North Korea or Iran", Policy Mic, 16.04. 2013, <http://www.policymic.com/articles/35149/north-korea-news-who-s-more-dangerous-north-korea-or-iran>, 23.02.2014.

¹⁶ Julian, Hatttem, "Why Do We Laugh at North Korea but Fear Iran?", The Atlantic, 04.04. 2013, <http://www.theatlantic.com/international/archive/2013/04/why-do-we-laugh-at-north-korea-but-fear-iran/274680/>, 01.04.2014.

këtë mënyrë për hartuesit e politikave evropiane është të paktën më pak i rëndësishëm nga aspekti strategjik.¹⁷

Nëse krahasojmë veprimet e ndërmarra të komunitetit ndërkombëtar e posaçërisht të SHBA-ve shihet qartë se SHBA-të, nuk qenë në gjendje për të eliminuar programin e armëve bërthamore në Korenë e Veriut. Në fakt ky program është zgjeruar edhe më tepër nën administrimin e Gorge W. Bushit. Kështu që gjatë gjashtë viteve të fundit, rezervate bërthamore të Koresë Veriore janë shtuar nga sasia materiale e mjaftueshme për një ose dy bomba deri në gjashtë ose deri në dymbëdhjetë bomba, të tëra këto të dhëna bazohen në literaturë publike. Reaktori në Yongbyon është riaktivizuar, kështu që deri në pranverë të vitit 2007, ka prodhuar plutonium të mjaftueshëm dhe nëse ndahet, atëherë ajo mund të prodhojë një ose dy bomba për çdo vit. Kështu që njëra nga pyetjet që mund të hasim vështirësi, në përgjigje dhe në qartësimin e saj është se : Cila është shuma e sasisë së plutoniumit që posedon Koreja e Veriut? A ka qenë në gjendje të përdorin këtë material për të prodhuar armë bërthamore, dhe në qoftë se po, sa? Cili është lokacioni i plutoniumit apo ndonjë armë tjetër bërthamore? Çfarë është madhësia fizike e ndonjë arme? A kanë prodhuar arsenalin apo raketat balistike Koreja e Veriut, apo se mund të shpërndahen vetëm në zonën e demilitarizuar (DMZ) me makina? Cila është gjendja e saktë e programit të pasurimit? A ka dhënë Koreja e Veriut ndonjë njohuri(dije) teknike, materiale ose armë bërthamore palëve të treta? Asnjëherë nga këto pyetje nuk i dihet

¹⁷ Thomas, Renard, "Partnering for a nuclear-safe world: the EU, its strategic partners and nuclear non-proliferation", European Strategic Partnership Observatory, ISSN 2254-6391 (print) ISSN: ESPO working paper n.3 October 2013, The ESPO website.strategicpartnerships.eu. 10.11.2014.

saktësisht përgjigja e duhur dhe njëherit këto janë sfidat kryesore të negociatave me Korenë e Veriut.¹⁸

Për më tepër edhe nëse këto armë në të ardhmen nuk do të përdoren kurrë, ose nuk do të shkaktojnë ndonjë aksident, qëllimi absolut i programeve të tyre bërthamore paraqet një sfidë të përditshme për qëndrueshmërinë e regjimit të traktateve dhe marrëveshjeve, veçanërisht bërthamore si: Traktatin e Mospërhapjes së Armëve Bërthamore (NPT) -që ka ndihmuar në dekadat e fundit të përmbajë kërcënimin që vjen nga përhapja e shfrenuar e armëve bërthamore dhe teknologjitë e tyre mbështetëse. Edhe pse në rishikimin pesëvjeçar të fundit i NPT-së në vitin 2005, i cili arriti në përfundimin në mënyrë të tillë që, ka vënë në dyshim rëndësinë e tij në të ardhmen, Irani ka përshpejtuar ciklin e karburantit të programit të plotë bërthamor, ndërsa Koreja e Veriut ka kryer një provë bërthamore. Për më tepër, Koreja e Veriut ka përfunduar një proces diplomatik, pavarësisht nga fakti se ajo ka nënshkruar NPT-në. Irani mbetet një kërcënim i vazhdueshëm për rajonin nëse del nga marrëveshja ndërkombëtare. Zgjerimi i kapaciteteve bërthamore dhe raketore nga Irani dhe Koreja e Veriut ndryshojnë faktet në terren. Irani ka braktisur një qasje të ngadalshme të pasurimit të uraniumit dhe Koreja e Veriut përshpejtoi programin e saj para hyrjes së sërishme në diplomacinë shumëpalëshe në shkurt të vitit 2007. Të dyja vendet kanë bashkëpunuar me tregun e zi bërthamor dhe shkencëtar pakistanez A.Q. Khan¹⁹ u ka siguruar

¹⁸ Patrick M. Cronin., *Double trouble: Iran and North Korea as challenges to international security*, Praeger Security International, 88 Post Road West, Westport, CT 06881, 2008, fq 108-111.

¹⁹ A.Q. Khan është bërë një pop ikonë për përhapjen bërthamore bashkëkohore, dhe fajësohet gjerësisht për ekzistencën e programeve të centrifugave të gazit të Pakistanit, Iranit, Libisë, dhe të Koresë së Veriut. Teknologjia e cila dominon nga politikëbërësit për përhapjen, më shumë e ndajnë mendimin se, "me përjashtim të disa vendeve të përparuara dhe industrializuara, aftësia e një shteti për të ndërtuar armë bërthamore në përgjithësi varet në aftësinë e tij dhe një furnizues ndërkombëtar." Për më shumë

të dyja këtyre vendeve me teknologji të centrifugave të gazit të nevojshme për të krijuar bombë bërthamore. Nëse këto dy vende lejohen të posedojnë armë nukleare atëherë disa analistë parashikojnë se një epokë e dytë bërthamore është e pashmangshme në Lindjen e Mesme dhe Azinë Lindore. Henry Kissinger shkruan, se "Bota po përballlet me perspektivën dhe makthin që armët bërthamore do të bëhen një standard dhe pjesë e armatimit kombëtar dhe këto do të bien në duart e terroristëve.²⁰

Përfundimi

Të dyja këto raste janë të ndryshme, ngase njëri shtet(Koreja e Veriut), tanimë posedon armë nukleare, ndërsa tjetri(Irani), në "vazhdimësi" është në përpjekje për të arritur deri tek aftësitë e tij nukleare. Andaj tek e para shtrohet çështja e zbatimit të nenit mbi çarmatimin e Traktatit të Mospërhapjes Bërthamore edhe pse nuk është anëtare e NPT-së, ndërsa tek programi nuklear i Iranit shtrohet çështja e shfrytëzimit paqësor e programit të saj nuklear. Kërcënimi ushtarak në rastin e Koresë së Veriut, nuk bën fare të shtrohet si opsion nga komuniteti ndërkombëtar, ngase pasojat do të ishin katastrofike për rajonin. Ndërsa tek rasti i Iranit kërcënimi mbi përdorimin e forcës i kombinuar me diplomacinë aktive, deri tani thuhet se ka arritur rezultate në momentin e shkrimit të këtij punimi. Zbatimi i mjeteve të diplomacisë shtrënguese si: sanksionet, presioni dhe kërcënimet

shih, në *Kemp,R.Scott*. "The Nonproliferation Emperor Has No Clothes."International Security 38, no. 4 (April 2014) , fq. 39-40.

²⁰ Patrick M. Cronin., *Double trouble: Iran and North Korea as challenges to international security*, Praeger Security International, 88 Post Road West, Westport, CT 06881, 2008, fq. 1 08-111.

me intervenim ushtarak edhe pse kanë dhënë efektet e tyre, nuk kanë dhënë rezultatet e pritura sa për ta ndaluar përparimin e programit bërthamor të Koresë së Veriut dhe nuk e kanë detyruar këtë shtet të ulet në tavolinën e bisedimeve. Nga marrëdhëniet ndërmjet SHBA-ve dhe partnerëve të tjerë negocius me Korenë e Veriut, si dhe mjetet e përdorura diplomatike deri më tani, në zgjidhjen e krizës bërthamore mund të konkludojmë se: Alternativa më e preferuar në zgjidhjen e krizës koreane është diplomacia aktive. Me zbatimin e kësaj diplomacie, Shtetet e Bashkuara si fuqi dominuese dhe botërore, "negociata nga fuqia" duhet të marrin iniciativën dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me udhëheqjen e re. Koreja e Veriut para së gjithash duhet të bjerë dakord për të kufizuar gradualisht programin e pasurimit, drejt çarmatimit. SHBA-të dhe partnerët e saj negociues duhet të bien dakord për të eliminuar në mënyrë graduale armatimin e tij bërthamor, ndërsa në anën tjetër komuniteti ndërkombëtar të heqë disa nga sanksionet më të rënda. SHBA-të dhe partnerët e saj negocius duhet të bien dakord për një proces për heqjen hap pas hapi të të gjitha sanksioneve të OKB-së si përgjigje e progresit të mëtejshëm dhe për ta integruar Korenë e Veriut në sistemin ndërkombëtar.

Bibliografia:

Ahmad, Shahab. North Korea News; Who is more dangerous, North Korea or Iran, Policy Mic, 16.04.2013, <http://www.policymic.com/articles/35149/north-korea-news-who-s-more-dangerous-north-korea-or-iran>, 23.02.2014.

Agreed Framework between The United States of America and The Democratic People's Republic of Korea, Geneva, October 21, 1994.

Gilbert, Rozman. Strategic Thinking about the Korean Nuclear Crisis: Four Parties Caught between

North Korea and the United States, Palgrave, Macmillian, 2007.

Goodenough, Patrick. Kerry Misleads in Saying There's No Comparison Between Iran and N. Korea Nuke Deals, CNN, news, November 25, 2013, <http://cnsnews.com/news/article/patrick-goodenough/kerry-misleads-saying-theres-no-comparison-between-iran-and-n-korea>.

Hatttem, Julian. Why Do We Laugh at North Korea but Fear Iran?, The Atlantic, 04.04. 2013, <http://www.theatlantic.com/international/archive/2013/04/why-do-we-laugh-at-north-korea-but-fear-iran/274680/>, 01.04.2014.

Hayes, Brown. 5 Reasons Why The Iran Deal Isn't North Korea Redux, Think Progress, 25.11.2013, <http://thinkprogress.org/security/2013/11/25/2989171/iran-deal-north-korea-redux/#>, 22.02. 2014.

John, Ishiyama. Assessing the leadership transition in North Korea: Using network analysis of field inspections, 1997-2012, Department of Political Science, University of North Texas, 1155 Union Circle # 305340, Wooten Hall, Room No. 166, Denton, TX 76203-5340, United States, 2014,

Joint Plan Of Action (JCPOA)., July 2014 for more visit, US. Department of State, <http://www.state.gov/e/eb/tfs/spi/iran/jcpoa/>.

Kemp, R. Scott. "The Nonproliferation Emperor Has No Clothes." *International Security* 38, no. 4 (April 2014)

Lazaroff, Tovah. Netanyahu to compare Iran with North Korea in UN speech, The Jerusalem Post, 24.09.2013, <http://www.jpost.com/Diplomacy-and-Politics/Netanyahu-to-compare-Iran-with-North-Korea-in-speech-to-UN-326918>, 26.02. 2014.

McEachern, North Korea and Iran, Drawing Comparative Lessons, U.S.-Korea Institute at SAIS, 2011.

Patrick M. Cronin., *Double trouble: Iran and North Korea as challenges to international security*, Praeger Security International, 88 Post Road West, Westport, CT 06881, 2008.

Renard, Thomas, *Partnering for a nuclear-safe world: the EU, its strategic partners and nuclear non-proliferation*, European Strategic Partnerships Observatory, ISSN 2254-6391 (print) ISSN: ESPO working paper n.3 October 2013, The ESPO website.strategicpartnerships.eu. 10.11.2014.

Sahay Usha. *A Tale of Two Outliers: Comparing Options on Iran and North Korea*, Lobelog Foerign Policy,22.02.2013,[http://www.lobelog.com/a-tale-of-two-outliers-comparing-options-on-iran-and-north korea](http://www.lobelog.com/a-tale-of-two-outliers-comparing-options-on-iran-and-north-korea).